

AKT THEMELIMI

i

“SETECH”

Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (Shpk)

Sot më datë 01.10.2022 palet e mëposhtme:

- **SRH SH.P.K.**, nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, themeluar sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise, me NIPT L71813009U dhe seli ne adresen Njesia Bashkiake nr. 5, Rruga Gjin Bue Shpata, ndertesa 11, hyrja 2, ap. 5, Tirane, Shqiperi; ligjerisht e perfaqesuar nga administratori z. Rubin Shehu, i biri i Bujarit, lindur më 06/12/1978, në Shkoder (Shqipëri), banues në Tiranë, mbajtës i ID me numër personal H81206111C,
- **Z. Rubin SHEHU**, individ, person madhor me te drejta te plota vepruese, i biri i Bujarit, lindur më 06/12/1978, në Shkoder (Shqipëri), banues në Tiranë, mbajtës i ID me numër personal H81206111C,

kane vendosur të nënshkruajnë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë “Shoqëria”), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti, se cilit i bashkengjitet.

Neni 1

EMËRTIMI

Emri i Shoqerise eshte "**SETECH**" (“Shoqëria”), ndjekur ne menyre te pandashme nga shkurtimi “Shpk”, i cili perfaqeson formen ligjore te saj.

Neni 2

SELIA

Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: Njesia Bashkiake nr. 5, Rruga Gjin Bue Shpata, ndertesa 11, hyrja 2, ap. 5, Tirane, Shqiperi.

Neni 3

KOHËZGJATJA

3.1 Kohezgjatja e Shoqerise eshte e pacaktuar ne momentin e themelimit.



Neni 4

OBJEKTI I SHOQËRISË

Zhvillim dhe mirembajtje sistemesh software. Dizenjim software-i. Analiza e kerkesave te sistemit software, projektimi i arkitektures dhe projektimi i detajuar i sistemit software. Testim software. Testimi i funksionaliteteve, te ngarkeses ne pune, te performances, te pranimit, te disponueshmerise dhe te sigurise se sistemit software. Dizenjim dhe zhvillim sistemesh te komunikimit. Programimi i sistemeve software, kodimi, instalimi, integrimi i te gjithe komponenteve, dokumentimi, identifikimi dhe korrighjimi i gabimeve, modifikimet (pas momentit qe software-i eshte vendosur ne operim), mirembajtja e te gjithe komponenteve, suporti i sistemit si nje teresi komponentesh, qe, ne funksionimin e tyre, realizojne qellimin e zgjidhjes informatike. Zhvillim sistemesh migrimi. Transferimi i te dhenave dhe infrastruktures perkatese nga nje teknologji e vjeter ne nje teknologji te re. Pemireshim/upgrade sistemesh informatike. Operimi, menaxhimi, suporti i perdorimit, trajnimi dhe auditimi teknik/informatik per sistemet software. Sherbime dhe konsulence ne fushen e sistemeve te Teknologjise se Informacionit dhe Komunikacionit (TIK). Zhvillimin, pemireshimin dhe integrimin e Software (programeve) kompjuterike ne fushat e Administrimit, Menaxhimit dhe raportimit Financiar; Implementimin e Platformave dhe Programeve WEB. Shoqeria mund te kryeje te gjitha aktivitetet e dobishme dhe/ose te nevojshme te lejuara nga legjislacioni ne fuqi, per realizimin e objektit te veprimtarise se Shoqerise.

Neni 5

KAPITALI THEMELTAR

- 5.1 Kapitali i Shoqërisë është i barabartë me 100.000 (njëqind mijë) lekë.
Kapitali themeltar i Shoqërisë është tërësisht i nënshkruar si më poshtë nga ortakët:
- **Rubin Shehu**, individ i cili zotëron 1 (një) kuotë të Shoqërisë me vlere nominale prej 51.000 (pesëdhjetë e një mijë) lekë që përfaqëson 51% të kapitalit të Shoqërisë.
 - **SRH SH.P.K.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar në Republikën e Shqipërisë me NIPT L71813009U zotëron 1 (një) kuotë të Shoqërisë me vlerë nominale prej 49.000 (dyzet e nëntë mijë) lekë që përfaqëson 49% të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 6

TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT

- 6.1 Pjesët e kapitalit i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

Neni 7

ADMINISTRIMI



- 7.1 Me këtë akt emërohet 1 (një) Administrator i Shoqërisë personi si më poshtë:
- Rubin SHEHU, lindur më 06 Dhjetor 1979, në Shkoder (Shqipëri), banues në Tiranë, mbajtës i ID me numër personal H81206111C, për një kohëzgjatje deri në 5 (pesë) vite me të drejtë riemërimi.
- 7.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14 prill 2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” dhe neneve 15, 16 dhe 17 të Statutit.
- 7.3 Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet e përmbushjes së detyrimeve të parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori, mund t’i drejtohet për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund t’u delegohet në tërësi ose pjesërisht kryerja e aktivitetit të sipërpërmendur.
- 7.4 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosi të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë t’i delegojë kompetencat e tyre personave të tjerë.

Neni 8

GJUHA

- 8.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

Ortaket Themelues:

Rubin Shehu

SRH SHPK

Perfaqesuar nga z. Rubin Shehu







